

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit **nr. 22/2018 “Për strehimin social”**; VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKM nr. 405, datë 01.06.2016 “Për miratimin e strategjisë së strehimit social 2016-2025”,

Bashkia Vau Dejës njofton të gjithë qytetarët e interesuar për të aplikuar për programet e strehimit që mund ta kryejnë procedurën në çdo kohë online, gjatë gjithë vitit në sistemin **e-Albania** përmes llogarisë personale, duke zgjedhur shërbimin ***“Kërkesë për të përfituar nga programet e Strehimit Social”***.

Të dhënat që plotësohen në formularin elektronik nga qytetarët do të postohen në sistem, duke krijuar regjistrin elektronik të aplikantëve që bëjnë kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social. Aplikimet do të përpunohen nga strukturat përgjegjëse për strehimin .

Aplikimi për të përfituar nga programet e strehimit social, me përjashtim të rasteve të nevojës emergjente për strehim, bëhet me dy faza.

Në fazën e parë, aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e strehimit social, sipas ligjit nr.22/2018 ‘Për strehim social’. Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t’u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit. Përmes këtij sistemi online do të vlerësohen kërkesat e ardhura gjatë fazës së parë, nëse mundet të kualifikohen për në fazën e dytë.

Aplikantët që kanë kaluar fazën e parë renditen sipas pikëzimit. Aplikantët do të njoftohen të “*Hapësira ime*” në portalin “e-Albania”, ose në adresën e tyre të postës elektronike për plotësim dokumentacioni. Secili prej aplikantëve do të ketë seksionin “dokumente plotësues”, ku do të mundësohet ngarkimi i gjithë dokumentacionit shtesë të kërkuar. Të gjitha dokumentet e bashkëlidhura nga aplikanti do të ruhen në dosjen e aplikantit.

Sipas ligjit, statusin e përfituesit nga programet sociale e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe është banorë i Bashkisë Vau Dejës, i cilit në momentin e aplikimit plotëson kushtet.

Përfitojnë familjet në nevojë dhe individët të cilët i përkasin shtresave me vunerabël të shoqërisë që nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ata që kanë mbetur të pastrehë; familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.